



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 776/1 prot.

Tiranë më/4 . 4.2022

Lënda: Dhënie mendimi mbi një projektvendim

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 1444/4 prot., datë 07.04.2022, protokolluar me tonën me nr. 776 prot., datë 11.04.2022, përmes së cilës dërgohet për mendim “*Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Arabe të Tunizisë mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar dhe protokollit të saj të zbatimit*”, bashkë me relacionin përkatës, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në tërësi, e vlerëson të hartuar në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar, (në vijim “*Ligji*”), megjithatë, do të çmonim të nevojshme marrjen në konsideratë të sugjerimeve si më poshtë:

Në përmbajtje të nenit 1 “*Përkufizime*” të Marrëveshjes, të përfshihet edhe përkufizimi i termit “*të dhëna personale*”, sipas përcaktimit të ligjit.

Gjithashtu sugjerojmë që, pika “f”, e nenit 16, të riformulohet, me qëllim kuptueshmërinë e saj, sipas përmbajtjes në vijim:

“Si autoriteti komunikues, ashtu edhe autoriteti marrës duhet të ndërmarrin çdo hap të arsyeshëm për të siguruar saktësinë që të dhënat duhet të kenë dhe, kur është e nevojshme, duhet të përditësohen si dhe duhet ndërmarrë çdo hap i arsyeshëm për të fshirë apo korrigjuar të dhëna të pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur apo për të cilin përpunohen më tej” .

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

